

## KIS Interpretimi 25

### ***Tatimet mbi të Ardhurat—Ndryshimet në statusin tatimor të një njësie ekonomike ose aksionerëve të saj***

#### Referenca

---

- SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare*
- SNK 8 *Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare*
- SNK 12 *Tatimet mbi të ardhurat*

#### Çështja

---

- 1 Një ndryshim në statusin tatimor të një njësie ekonomike ose të aksionarëve të saj mund të ketë pasoja për njësinë ekonomike duke rritur ose ulur detyrimet ose aktivet e saj tatimore. Kjo për shembull mund të ndodhë me listimin publik në bursë të instrumenteve të kapitalit të vet të njësisë ekonomike ose me ristrukturimin e kapitalit të vet të njësisë ekonomike. Kjo gjithashtu mund të ndodhë me zhvendosjen e një aksionari kontrollues në një shtet tjetër. Si rezultat i ngjarjeve të tilla, njësia ekonomike mund të tatohet ndryshe; ajo mundet për shembull të përfitojë ose humbasë lehtësi tatimore ose të bëhet subjekt i një përqindje tatimore të ndryshme në të ardhmen.
- 2 Një ndryshim në statusin tatimor të një njësie ekonomike ose të aksionarëve të saj mund të ketë një efekt të menjëhershëm ndaj detyrimeve ose aktiveve tatimore aktuale të njësisë ekonomike. Ndryshimi gjithashtu mund të rrisë ose të ulë detyrimet dhe aktivet tatimore të shtyra të njohura nga njësia ekonomike, në varësi të efektit që ka ndryshimi i statusit tatimor në pasojat tatimore që krijohen nga rikuperimi ose shlyerja e vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të njësisë ekonomike.
- 3 Çështja është se si njësia ekonomike duhet të kontabilizojë pasojat tatimore të një ndryshimi në statusin e saj tatimor ose në atë të aksionarëve të saj.

#### Konsensusi

---

- 4 Ndryshimi në statusin tatimor të njësisë ekonomike ose të aksionarëve të saj nuk krijon rritje ose ulje në shumat e njohura drejtpërdrejt në kapitalin e vet. Pasojat tatimore aktuale dhe të shtyra të ndryshimit në statusin tatimor do të përfshihen në fitimin ose humbjen e periudhës, përveçse kur këto pasoja lidhen me transaksione dhe ngjarje që rezultojnë, në të njëjtën periudhë ose në një periudhë tjetër, me një kreditim ose debitim të drejtpërdrejt të një shume të njohur në kapitalet e veta ose të shume të njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Ato pasoja tatimore që lidhen me ndryshimet në shumën e njohur në kapitalet e veta, në të njëjtën ose periudha të ndryshme (të pa përfshira në fitimin ose humbjen), do të kalohen ose kreditohen drejtpërdrejt në kapitalin e vet. Ato pasoja tatimore që lidhen me shumën e njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse do të njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

#### Data e Konsensusit

---

gusht 1999

#### Data e hyrjes në fuqi

---

Ky konsensus hyri në fuqi në 15 korrik 2000. Ndryshimet në politikat kontabël do të bëhen në përputhje me SNK 8.

SNK 1 (rishikuar në 2007) ndryshoi terminologjinë e përdorur në të gjithë SNRF-të. Në përputhje me këtë u ndryshua paragrafi 4. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore nga 1 janar 2009 e në vazhdim.

Nëse një njësi ekonomike zbaton SNK 1 (rishikuar në 2007) për një periudhë më të hershme, ndryshimet do të zbatohen për këtë periudhë më të hershme.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Në prill 2024, BSNK publikoi SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* dhe mbarti këto kërkesa të SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* tek SNRF 18.